



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.20, datë 07.12.2021

MBI

“SHTYRJEN E AFATIT TË HYRJES NË FUQI TË RREGULLORES NR.49, DATË 11.03.2021, “PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE PAJTIMTARËVE TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PUBLIKE””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Xhoana	Lilaj	Anëtar
5. Z. Lorenc	Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 07.12.2021 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe me propozim të DDP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të Rregullores Nr.49, datë 11.03.2021, “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.*

BAZA LIGJORE:

1. Neni 98 e vijues i ligjit nr. 9918, datë 19. 5. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 9918/2018);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji nr.44/2015).

K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: *"Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike"*, miratuar me VKD nr.2, datë 11.03.2021 (në vijim referuar Rregullore 49/2021);
- VKD nr. 17, datë 04.12.2021 "Për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të Rregullores nr.49, datë 11.03.2021, *"Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike"*.
- Relacioni shoqëruar i projektaktit miratues (Relacioni);
- Projektvendimi;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2, datë 11.03.2021, ka miratuar dokumentin *"Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike"*. Rregullorja 49/2021 u miratua pas procesit të këshillimit publik me palët e interesuara dhe u publikua në faqen e internetit të AKEP më datë 04.04.2021. Pas publikimit të dokumentacionit të Rregullores nr. 49/2021, AKEP ka kryer njoftimet përkatëse pranë sipërmarrësve.
2. Rregullorja nr.49, datë 11.03.2021, përcakton se hyn në fuqi 6 muaj pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP dhe publikimit në faqen e internetit të AKEP. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen:
 - Rregullore nr.29, datë 29.5.2013, *"Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike"*;
 - Rregullore nr.31, datë 26.12.2013, *"Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike"*.
3. Përcaktimet e Rregullores nr.49/2021 sjellin një sërë përmirësimesh në marrëdhëniet e sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike me konsumatorët dhe pajtimtarët, përfshirë edhe nevojën për reflektimin e këtyre ndryshimeve në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave midis sipërmarrësve me pajtimtarët, kontrata të cilat sipas përcaktimeve të nenit 99, të ligjit 9918, hartohen nga sipërmarrësit dhe vlerësohen nga AKEP.
4. AKEP përgjatë muajve gusht edhe shtator ka kryer komunikime elektronike me sipërmarrësit për depozitimin në AKEP të termave dhe kushteve të reja të kontratave tip sipas Rregullores nr. 49/2021, bazuar në përcaktimet ligjore. Sipërmarrësit kanë kërkuar mirëkuptimin e AKEP për depozitimin dokumentacionit përkatës më datë 24.09.2021. Këtë kërkesë sipërmarrësit e argumentojnë me përcaktimet e pikës 5 të nenit 99 të Ligjit 9918/2008 (depozitim në AKEP të kontratës tip/ndryshimet e saj 15 ditë para hyrjes në

fuqi të saj/tyre), kompleksitetin e çështjeve dhe dispozitave të reja të Rregullores nr. 49/2021, të cilat duhen të jenë të reflektuara në kontratat e pajtimit (shërbime nga rrjete celulare dhe/ose fikse), si dhe nevojën për koordinim të brendshëm me disa departamente në kompanitë respektive.

5. Sipërmarrësit kanë depozituar në AKEP dokumentacionin e hartuar për kontratat tip sipas Rregullores nr.49, datë 11.03.2021. Nga ku rezultoi se, dokumentacioni i depozituar nga sipërmarrësit në përgjithësi i ka reflektuar ndryshimet e kërkuara nga Rregullorja 49/2021, por AKEP vëren se termat dhe kushtet e përgjithshme dhe elementë të tjerë të kontratave tip të depozituara kanë nevojë për ndryshime dhe përcaktime ligjore më të qarta, për të qenë plotësisht në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918/2008 dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të aplikueshme, përfshirë këtu edhe përcaktimet e Rregullores 49/2021.
6. Për tu dhënë kohë sipërmarrësve për të përgatitur kontratat e pajtimtarëve AKEP me VKD nr. 17, datë 04.12.2021 “Për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të Rregullores nr.49, datë 11.03.2021, *“Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*, vendosi të shtyjë afatin e hyrjes në fuqi për në datën 15 dhjetor 2021.
7. Në vijim, në datën 10.11.2021 AKEP zhvilloi takim me tre të tre sipërmarrësit ku u diskutuan termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të depozituara prej tyre në fund të muajit shtator 2021. Në takim u sqaruan çështjet të cilat mungonin në draft kontratat e sjella nga sipërmarrësit si edhe u dhanë shpjegime lidhur me përcaktimet e kontratave.
8. Në përfundim, AKEP duke marrë në konsideratë konkluzionet e takimit, duhet të njoftoj zyrtarisht sipërmarrësit lidhur me vleresimet për draftet e paraqitura të kontratave, duke i lënë kohën e mjaftueshme ligjore sipërmarrësve të përgatisin draftet finale si dhe të kryejnë publikimin në faqen e tyre të internetit të kontratave tip, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9918/2008, gjithashtu edhe të kryejnë njoftimin e pajtimtarëve brenda afateve ligjore.
9. Për sa mësipër, AKEP gjykon të arsyeshme të shtyjë afatin e hyrjes në fuqi të Rregullores nr. 49/2021.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e procesit të hartimit nga sipërmarrësit të termave dhe kushteve të reja të përgjithshme të kontratave tip të pajtimtarëve dhe vlerësimit të tyre nga AKEP, për përpushmërinë me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës, përfshirë Rregulloren 49/2021, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të shtyjë afatin e hyrjes në fuqi të Rregullores nr.49, datë 11.03.2021, “Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, më datë 01.02.2022.
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.
3. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtave të Përdoruesve për njoftimin e palëve të interesuara dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtave të Përdoruesve për të përfunduar së bashku me sipermarrësit brenda muajit dhjetor 2021, termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Tomi Frashëri

ANËTAR

Ketrin Topçiu

ANËTAR

Edlira Dvorani

ANËTAR

Xhoana Lilaj

ANËTAR

Lorenc Bako